



Fabrice Henard është një konsulent ndërkombëtar i specializuar në politikat e arsimit si dhe sigurimin e cilësisë. Ai ka punuar për më shumë se 18 vjet në fushën e vlerësimit të politikave publike, veçanërisht për projekte evropiane dhe ndërkombëtare që kanë të bëjnë me sigurimin e cilësisë, ndërkombëtarizimin, qeverisjen dhe cilësinë e mësimdhënies dhe të të nxënit në arsimin e lartë në Evropë, Azi, Afrikë dhe Magreb. Fabrice është Sekretar i Përgjithshëm i Komitetit të Akreditimit të Luksemburgut që nga viti 2013.

Ai është anëtar i Këshillit për Akreditimin e Arsimit të Lartë (CHEA) në SHBA dhe një prej redaktorëve të revistës Journal Quality. Projektet e fundit të drejtuara nga z. Henard janë: Ndihmë për funksionalizimin e Agjencisë marokene të sigurimit të cilësisë (e financuar nga BE), Projekti punësimi në arsimin e lartë në Tunizi (Banka Botërore), Krijimi e Zonës së Arsimit të Lartë Aziatik në Azinë Juglindore, Rishikimi i sistemit shqiptar dhe malazez të sigurimit të cilësisë (Banka Botërore).

Fabrice është konsulent në sigurimin e cilësisë dhe në politikat arsimore nga agjencitë e sigurimit të cilësisë (Belgjikë, Armeni), Kombet e Bashkuara (UNICEF, UNESCO, UNFPA), Banka Botërore, Komisioni Evropian, Shoqata e Universiteteve Frankofone dhe OJQ të ndryshme. Në vitin 2016, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit dhe Kulturës e BE-së e zgjodhi atë si ekspert kombëtar për Francën për politikat arsimore. Fabrice ka qenë analist në Organizatën për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik në programin e OECD për arsimin e lartë (2007-2013), vlerësues në Agjencinë Franceze të Sigurimit të Cilësisë (2003-2007) i përfshirë në projektet evropiane të cilësisë (ENQA) si dhe konsulent i lartë në Qendrën për Vlerësim dhe Ekspertizë Evropiane (1999-2003). Fabrice është diplomuar në SciencesPo-University.